



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Power Engineering" të datës 07.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "155 Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës për IEA" me nr. të prokurimit 616-26-1531-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Power Engineering shpk" të datës 07.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "155 Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës për IEA" me nr. të prokurimit 616-26-1531-1-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Power Engineering shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 07.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "155 Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës për IEA" me nr. të prokurimit 616-26-1531-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

- Parashtruesi kërkon të largohen të gjitha kërkesat për ISO standarde;
- Parashtruesi kërkon të largohen të gjitha kërkesat për pajisje/automjete.

Pas analizimit me kujdes të kërkesa të DT është gjetur se kërkesa për ISO 1996-2 2017 mund të largohet nga DT për shkak se nuk është e domosdoshme mirëpo të gjitha kërkesat tjera për ISO janë absolutisht të domosdoshme për të siguruar standardin e cilësisë me rastin e realizimit të projektit. Prandaj të tjerat kërkesa për ISO mbesin të pandryshuara.

Po ashtu, edhe sa i përket pajisjeve/automjeteve, kërkesa për Kombi me rimorkio peshë bartëse 1402 kg mund të largohet pasi që është formuluar gabimisht duke qenë se pesha bartëse është cekur fikse dhe nuk është lejuar minimumi dhe maksimumi. Mirëpo të gjitha kërkesat tjera për pajisje/automjete janë absolutisht të domosdoshme për të realizuar projektin në mënyrë efikase dhe efektive dhe si të tilla mbesin të pandryshuara.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatorëve ekonomik"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 14.04.2026



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.